



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 6 janar 2015, në mbledhjen VIII – të (tetë) të Komitetit për Komunitete.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 11.00'.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Shaban Ahmeti, kryesuesi i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti, përkatësisht z. Bahri Selimi, z. Mefail Rama,, z. Shaban Osmani, z. Xhafer Ademi dhe z. Xhevdet Beselica, ndërsa mungoi z. Radisav Perović.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe z. Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, z. Ylber Salihu, zyrtar për Integrime Evropiane, z. Bashkim Bajrami, Komanda Rajonale Kufitare – Veriu, z. Fadil Babatinca, Stacioni i Policisë në Podujevë, z. Muharrem Haziri, OSBE dhe z. Hajnalka Vida, KFOR, LMT.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i propozuar u miratua njëzëri.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 4 dhjetor 2014

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri.

3. Propozimi i Raportit të punës për vitin 2014

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, e paraqiti fjalën e hyrjes.

z. Shaban Osmani, zëvendëskryesues, e lexi propozimin e raportit të punës.

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, theksoi, një prej brengave të këtij Komiteti ka qenë pamundësia për ofrimin e ndihmave të gjitha familjeve RAE të cilat kanë pas nevojë për dru për djegie, nevojë e cila paraqitet edhe në muajt në vijim dhe shtoi, lidhur me këtë kam biseduar me drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe drejtorin e Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit

Rural të cilët më kanë informuar se nuk ka mundësi për ofrimin e ndihmave të druve për djegie.

z. Shaban Osmani, zëvendëskryesues, theksoi, pajtohem me kryesuesin z. Shaban Ahmetin për çështjen të cilën e potencoi dhe shtoi, ne jemi në dijeni se ky Komitet nuk është vendimmarrës, andaj lidhur me çështjen e cekur jam i mendimit që Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural t'i drejtohemi me një rekomandim që të shqyrtojnë të gjitha mundësit për ofrimin e ndihmave në dru për djegie në sasi 2 m^3 së paku 20 familjeve RAE.

z. Xhevdet Beselica, theksoi, pajtohem se ka familje të komuniteteve RAE të cilat kanë nevojë të madhe për dru për djegie gjithashtu jemi në dijeni se Komuna disponon me një sasi të konsiderueshme të druve të konfiskuara për shkak se janë prerë pa leje përkatëse, mirëpo duhet të kemi parasysh se Agjicioni Pyor i Kosovës është përgjegjës për administrimin dhe menaxhimin e pyjeve. Para një apo dy viteve e kam lexuar një artikull sipas të cilil ndaj Komunës është ngritur një padi nga Agjicioni Pyor i Kosovës për shkak se një pjesë të druve të konfiskuara ua ka ndarë disa familjeve në nevojë, ngase drutë e konfiskuara sipas një rregulloreje duhet të shiten përmes ankandit publik.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua Raporti i punës për vitin 2014.

4. Të ndryshme

Plani i punës për vitin 2015, i korrigjuar mbi bazën e propozimeve të miratuara në mbledhjen e mbajtur më 4 dhjetor 2014.

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, theksoi, në mbledhjen e kaluar është miratuar Plan i punës i këtij Komiteti për vitin 2015 dhe propozoi që edhe një herë të rishqyrtohet rekomandimi për sigurimin e mjeteve buxhetore për realizimin e aktiviteteve të këtij Komiteti.

z. Shaban Osmani, propozoi që për kremin festës së Flamurit të komunitetit ashkali shuma prej 700 € të zbritet në 600 €, ndërsa për kremin festës së Flamurit të komunitetit rom shuma prej 200 € të ngritet në 300 € dhe për organizimin e një vizite në Podujevë të përfaqësuesve të Komiteteve të Komuniteteve të komunave të regjionit të Prishtinës, shuma prej 400 € të zbritet në 300 €.

Pas votimit u konstatua se propozimet e parafolësít u miratuan njëzëri.

z. Muharrem Haziri, përfaqësues i OSBE – së, theksoi, në muajin prill 2015 është faza e përgatitjes së buxhetit për vitin 2016, andaj ky Komitet do duhej të përcaktohet për propozimet konkrete buxhetore për realizimin e objektivave të planifikuara në mënyrë që të mos mendohet se nga cili burim do të merren mjetet financiare, ngase në buxhet çdo shpenzim është i koduar.

Shpesh përmenden sigurimi i mjeteve financiare për dimërim, përkatësisht për plotësimin e nevojave familjeve në gjendje të rënd sociale, andaj ky Komitet në fazën e përgatitjes së buxhetit mund të paraqet propozime për shumë të caktuar lidhur me këtë çështje.

z. Liman Zeqiri, theksoi, sa i përket sigurimit të mjeteve financiare për dimërim për plotësimin e nevojave më elementare të familjeve në gjendje të rëndë sociale, kjo

çështje është në kompetencë të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, përkatësisht Sektorit të Mirëqenies Sociale, ku për sezonin e dimrit parashihet një fond i caktuar buxhetor dhe në kuadër të këtij fondi familjet e komuniteteve pakicë janë përfituese së paku 10% në të gjitha rastet e ofrimit të ndihmave.

Mbledhja përfundoi në orën 11.30'.

Procesverbalin e mbajti
Faik Gashi

Nr. 01-006-3744
Podujevë,
6 janar 2015

Kryesuesi i Komitetit
Shaban Ahmeti